

[d@dalos](#)[home](#)[site map](#)

D@dalos

Karta e OKB-se

[Lart](#)[Kursi baze 2](#)[Kursi baze 3](#)[Kursi baze 4](#)[Kursi baze 5](#)[Karta e OKB-se](#)

Kombet e Bashkuara



Karta e Kombeve te Bashkuara

[nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko; hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945]

Preambula

NE, POPUJT E KOMBEVE TE BASHKUARA ,

të vendosur të mbrojmë brezat e ardhshëm nga kamxhiku i luftës, i cili në ditët tona ka sjellë dy herë vuajtje të pathëna mbi njerëzimin,

të forcojmë sërish besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerat e personalitetit njerëzor, në barazinë mes burrit dhe gruas si dhe mes gjithë kombeve, qofshin këto të mëdha a të vogla,

DHE PËR KËTË QËLLIM

të ushtrojmë durimin dhe të jetojmë në paqe si fqinjë të mirë,

të bashkojmë forcat tona, në mënyrë që të ruajmë paqen në botë dhe sigurinë ndërkombëtare,

të pranojmë parimet dhe të fusim procedurat, që garantojnë përdorimin e armëve vetëm për interesin e përgjithshëm, dhe

të marrim në konsideratë institucione ndërkombëtare me qëllim, që të mbështesim përparimin ekonomik dhe social të të gjithë popujve -

VENDOSËM TË PËRPIQEMI BASHKARISHT PËR ARRITJEN E KËTYRE QËLLIMEVE.

Në këtë mënyrë qeveritë tona, përmes përfaqësuesve të tyre, mbledhur në San Francisko, të cilët kanë paraqitur plotfuqitë e tyre në formën përkatëse, kanë pranuar Kartën e Kombeve të Bashkuara duke krijuar kështu një organizatë ndërkombëtare nën emërtimin "Kombet e Bashkuara".

[Kapitulli I:](#) Qëllimet dhe parimet

[Kapitulli II:](#) Anëtarësia

Solar Energy Charity

Helping Relieve
Poverty Through
The Provision of
Solar Energy.
Join Us!

Oglasi Google –
javne storitve

Kapitulli III:	Organet
Kapitulli IV:	Asambleja e Përgjithshme
Kapitulli V:	Këshilli i Sigurimit
Kapitulli VI:	Zgjidhja paqësore e konflikteve
Kapitulli VII:	Masat në rast kërcënimi ose thyerjeje të paqes si dhe në rast sulmesh
Kapitulli VIII:	Marrëveshje rajonale
Kapitulli IX:	Bashkëpunimi ndërkombëtar në sektorin ekonomik dhe social
Kapitulli X:	Këshilli ekonomik dhe social
Kapitulli XI:	Deklaratë mbi territoret shtetërore pa vetëqeverisje
Kapitulli XII:	Sistemi ndërkombëtar i mirëbesimit
Kapitulli XIII:	Këshilli i Kujdestarisë
Kapitulli XIV:	Gjykata Ndërkombëtare
Kapitulli XV:	Sekretariati
Kapitel XVI:	Të ndryshme
Kapitulli XVII:	Dispozita kalimtare mbi sigurinë
Kapitulli XVIII:	Ndryshime
Kapitulli XIX:	Ratifikimi dhe nënshkrimi

Kapitulli I: Qëllimet dhe parimet

Neni 1

Kombet e Bashkuara marrin përsipër:

1. të ruajnë paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare dhe, për këtë qëllim, të marrin masa kolektive të efektshme për të parandaluar dhe mënjanuar kërcënimet e paqes, për të mposhtur veprimet mësymëse dhe shkeljet e tjera të paqes, si dhe për të zgjidhur me mjete paqësore sipas parimeve të drejtësisë dhe të drejtës ndërkombëtare konflikte ndërkombëtare apo situata, që do të mund të çonin në shkelje të paqes;
2. të zhvillojnë marrëdhënie miqësore mes kombeve, të cilat bazohen në parimet e barazisë dhe të vetëvendosjes së popujve si dhe të marrin masa të tjera të përshtatshme për konsolidimin e paqes;
3. të ngrenë në këmbë një bashkëpunim ndërkombëtar për të zgjidhur probleme ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, kulturore dhe humanitare si dhe për të mbështetur dhe forcuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe apo besimi fetar;
4. të jenë qendra, në të cilën koordinohen me njëra-tjetrën përpjekjet e kombeve për të realizuar këto qëllime të përbashkëta.

Neni 2

Organizata dhe anëtarët e saj veprojnë në zbatim të qëllimeve të përcaktuara në nenin 1 sipas parimeve të mëposhtme:

1. Organizata bazohet në parimin e barazisë sovrane të të gjithë anëtrëve të saj.
2. Të gjithë anëtarët pëmbushin në mirëbesim të gjitha detyrimet, që ata marrin përsipër me anë të Kartës, me qëllim që të sigurojnë të drejtat dhe privilegjet, që u takojnë nga anëtarësia.
3. Të gjithë anëtarët i zgjidhin konfliktet e tyre me mjete paqësore, në mënyrë të tillë që paqja botërore, siguria ndërkombëtare dhe drejtësia të mos rrezikohen.
4. Të gjithë anëtarët ndalojnë në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare çdo kërcënim apo përdorim dhune, që drejtohet kundër paprekshmërisë territoriale apo pavarësisë politike të një shteti ose që bie ndesh me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.
5. Të gjithë anëtarët u japin Kombeve të Bashkuara asistencën e nevojshme për çdo masë, që Organizata merr në përputhje me Kartën; një shteti, ndaj të cilit Organizata ka marrë masa parandaluese apo detyruese, ato nuk i japin mbështetjen e tyre.
6. Organizata kujdeset, që shtetet jo-anëtare të Kombeve të Bashkuara të veprojnë sipas këtyre parimeve, për sa kohë që kjo është e nevojshme për ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare.
7. Nga kjo Kartë nuk rezulton e drejta e Kombeve të Bashkuarapër të ndërhyrë në çështje të tilla, që për nga natyra bëjnë pjesë në kompetencat e brendshme të një shteti, apo detyrimi i shteteve anëtare, që për çështje të tilla të zbatojnë një rregullore me bazë Kartën; zbatimi i masave detyruese sipas kapitullit të VII nuk preket nga ky parim.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli II: Anëtarësia

Neni 3

Anëtarë fillestarë të Kombeve të Bashkuara janë ato shtete, të cilat kanë marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi një Organizatë Ndërkombëtare në San Francisko ose që kishin nënshkruar që më parë Deklaratën e Kombeve të Bashkuara të datës 1 janar 1942 dhe që tashmë nënshkruajnë këtë kartë dhe e ratifikojnë atë sipas nenit 110.

Neni 4

(1) Anëtarët e Kombeve të Bashkuara mund të jenë të gjithë shtetet e tjera paqedashëse, që marrin përsipër detyrimet e kësaj Karte dhe që, sipas vlerësimit të organizatës, janë të afta dhe të vullnetshme të pëmbushin këto detyrime.

(2) Pranimi i një shteti të tillë si anëtar i Kombeve të Bashkuara bëhet me rekomandim të Këshillit të Sigurimit dhe vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5

Asambleja e Përgjithshme, me rekomandim të Këshillit të Sigurisë, mund t'i mohojë një shteti anëtar, kundër të cilit Këshilli i Sigurimit ka marrë masa parandaluese apo detyruese, në mënyrë të përkohëshme ushtrimin e të drejtave dhe privilegjeve, që rrjedhin nga anëtarësia.

Neni 6

Një anëtar i Kombeve të Bashkuara, i cili shkel në mënyrë të vazhdueshme parimet e kësaj Karte, Asambleja e Përgjithshme mund ta përjashtojë nga organizata me rekomandim të Këshillit të Sigurimit.

[\[Permbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli III: Organet

Neni 7

(1) Organet kryesore të Kombeve të Bashkuara janë Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Sigurimit, Këshilli Ekonomik dhe Social, Këshilli i Kujdestarisë, Gjykata Ndërkombëtare dhe Sekretariati.

(2) Sipas nevojës mund të vihen në veprim në përputhje me këtë Kartë edhe organe dytësore.

Neni 8

Kombet e Bashkuara nuk aplikojnë kufizime në lidhje me barazinë gjinore mes burrave dhe grave pësa u përket të gjitha vendeve të punës në organet kryesore dhe dytësore.

[\[Permbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli IV: Asambleja e Përgjithshme

Përbërja

Neni 9

(1) Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara.

(2) Secili prej anëtarëve ka jo më shumë se pesë përfaqësues në Asamblenë e Përgjithshme.

Detyrat dhe kompetencat

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë në shqyrtim të gjitha çështjet, që bien brenda kuadrit të Kartës ose që kanë të bëjnë me të drejtat e njërit prej organeve të parashikuara në këtë Kartë; me kusht respektimin e nenit 12, ajo mund të japë rekomandimet e saj në lidhje me këto çështje, drejtuar anëtarëve të Kombeve të Bashkuara ose Këshillit të Sigurimit ose të dyve bashkë.

Neni 11

(1) Asambleja e Përgjithshme mund të merret me të gjitha parimet e përgjithshme të bashkëpunimit për ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare duke përfshirë këtu parimet e çarmatosjes dhe rregullores së armatimit si dhe, duke iu referuar këtyre parimeve, t'u drejtojë rekomandime anëtarëve ose Këshillit të Sigurimit, sse të dyve.

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të shqyrtojë të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe që i parashtrihen asaj nga një anëtar i Kombeve të Bashkuara ose nga Këshilli i Sigurimit ose nga një shtet jo-anëtar i Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 35 kreu 2; me kusht respektimin e nenit 12, ajo mund t'u drejtojë shteteve të prekura ose Këshillit të Sigurimit ose të dyve rekomandime në lidhje me këto çështje. Nëse në kuadër të një çështjeje të tillë lind nevoja e masave të ndryshme atëherë Asambleja e Përgjithshme ia kalon atë para ose pas shqyrtimit Këshillit të Sigurimit.

(3) Asambleja e Përgjithshme mund të tërheqë vëmendjen e Këshillit të Sigurimit në lidhje me ato situata, të cilat përbëjnë rrezik për paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare.

(4) Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme sqaruar në këtë nen nuk kufizojnë efektin e përgjithshëm të nenit 10.

Neni 12

(1) Për sa kohë që Këshilli i Sigurimit realizon detyrat e tij parashikuar nga Karta në rast konflikti apo në një situatë të caktuar, Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të japë asnjë rekomandim, përveç rastit kur kjo kërkohet nga Këshilli i Sigurimit.

(2) Sekretari i Përgjithshëm, me miratimin e Këshillit të Sigurimit i raporton Asamblesë së Përgjithshme në çdo sesion të kësaj të fundit në lidhje me të gjitha çështjet e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, që trajtohen nga Këshilli i Sigurimit; gjithashtu, ai njofton menjëherë Asamblenë e Përgjithshme, ose, në mungesë të sesionit të kësaj të fundit, Anëtarët e Kombeve të Bashkuara, sapo Këshilli i Sigurimit pezullon trajtimin e një çështjeje të tillë.

Neni 13

(1) Asambleja e Përgjithshme inicion procese hetimore dhe jep rekomandime;

a) për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën politike dhe për të favorizuar zhvillimet progresive të së drejtës ndërkombëtare dhe kodifikimin e saj;

b) për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e ekonomisë, sistemit social, kulturës, edukimit dhe shëndetësisë si dhe për të kontribuar në realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij pa dallim race, gjinie, gjuhe apo besimi fetar.

(2) Përgjegjësitë e mëtejshme, detyrat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me çështjet e përmendura në kreun 1, gërma b përshkruhen në kapitujt IX dhe X.

Neni 14

Me kusht respektimin e nenit 12 Asambleja e Përgjithshme mund të japë

rekomandime për neutralizimin paqësor të çdo situatë, pavarësisht se si ka lindur ajo, nëse kjo situatë duket se është e prirur të bjerë ndesh me të mirat e përgjithshme ose me marrëdhëniet miqësore mes kombeve; e njëjta gjë vlen edhe për ato situata, që janë pasojë e shkeljeve të dispozitave të kësaj Karte mbi qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

(1) Asambleja e Përgjithshme merr dhe analizon raportet vjetore dhe raportet speciale të Këshillit të Sigurimit; pjesë e këtyre raporteve është edhe pëshkrimi i masave, që Këshilli i Sigurimit ka vendosur të marrë ose ka marrë tashmë për ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare.

(2) Asambleja e Përgjithshme merr dhe analizon raportet e organeve të tjera të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme realizon detyrat e saj përcaktuar në kapitujt XII dhe XIII mbi sistemin ndërkombëtar të Këshillit të Kujdestarisë; këtu bën pjesë edhe miratimi i marrëveshjeve të mirëbesimit/kujdestarisë për ato zona, që nuk janë cilësuar si zona strategjike.

Neni 17

(1) Asambleja e Përgjithshme shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e organizatës.

(2) Shpenzimet e organizatës merren përsipër nga anëtarët e organizatës sipas një kodi shpërndarjeje, i cili duhet të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

(3) Asambleja e Përgjithshme shqyrton dhe miraton të gjitha marrëveshtjet financiare dhe buxhetore me organizatat e veçanta cilësuar në nenin 57; ajo analizon buxhetin e tyre administrativ me qëllim që t'u japë atyre rekomandime.

Votimi

Neni 18

(1) Çdo anëtar i Asamblesë së Përgjithshme ka një votë.

(2) Vendime të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me çështje të rëndësishme kërkojnë një shumicë prej dy të tretash të anëtarëve të pranishëm votues. Në këto çështje bëjnë pjesë: rekomandime në lidhje me ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare, zgjedhje e anëtarëve jo të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Social-Ekonomik, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Kujdestarisë sipas nenit 86 kreu 1, gërma c, pranimi i anëtarëve të rinj në Kombet e Bashkuara, heqja e përkohshme e të drejtave dhe privilegjeve, që rrjedhin nga anëtarësia, përjashtimi i anëtarëve, çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e veprimit të sistemit të mirëbesimit si dhe çështje të buxhetit.

(3) Vendime në lidhje me çështje të tjera, duke përfshirë këtu përcaktimin e grupeve të tjera çështjesh, për të cilat vendoset me shumicën e dy të tretave, kërkojnë shumicën e anëtarëve të pranishëm votues.

Neni 19

Një anëtar i Kombeve të Bashkuara, i cili ka mbetur prapa me pagesën e kontributeve të veta financiare, nuk ka të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, nëse shuma e papaguar arrin apo kalon vlerën e kontributeve, që ky anëtar duhej të kishte paguar në dy vitet e plota paraardhëse. Asambleja e Përgjithshme mund t'i lejojë atij sërish ushtrimin e të drejtës së votës, nëse ajo ka bindjen se kjo vonesë në pagesë ka për arsye rrethana, për të cilat nuk mban përgjegjësi ky anëtar.

Proçedura

Neni 20

Asambleja e Përgjithshme mblidhet rregullisht një herë në vit dhe, nëse e kërkojnë rrethanat, në sesione të jashtëzakonshme. Sesionet e jashtëzakonshme thirren nga Sekretari i Përgjithshëm me kërkesë të Këshillit të Sigurimit ose shumicës së anëtarëve të Kombeve të Bashkuara.

Neni 21

Asambleja e Përgjithshme jep rendin e aktivitetit. Për çdo sesion ajo zgjedh presidentin e vet.

Neni 22

Asambleja e Përgjithshme mund të verë në veprim organe dytësore, nëse e konsideron këtë të nevojshme për realizimin e detyrave të saj.

[\[Permbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli V: Këshilli i Sigurimit

Përbërja

Neni 23

(1) Këshilli i Sigurimit përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë të Kombeve të Bashkuara. Republika e Kinës, Franca, Bashkimi Sovjetik, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë dhe Irlanda e Veriut si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit. Asambleja e Përgjithshme zgjedh dhjetë anëtarë të tjerë të Kombeve të Bashkuara si anëtarë jo të përhershëm të Këshillit të Sigurimit; këtu duhen marrë parasysh në mënyrë të veçantë pikëpamjet e mëposhtme: në radhë të parë kontributi i anëtarëve të Kombeve të Bashkuara në ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare ai dhe në realizimin e objektivave të tjera të organizatës, e më tej edhe shpërndarja e përshtatshme gjeografike e vendeve.

(2) Anëtarët jo të Përhershëm të Këshillit të Sigurimit zgjidhen për një periudhë dyvjeçare. Gjatë zgjedhjes së parë të anëtarëve jo të përhershëm, që zhvillohet pas rritjes së numrit të anëtarëve të Këshillit nga 11 në 15, zgjidhen dy nga katër anëtarët shtesë për një periudhë njëvjeçare. Anëtarët, që largohen nuk mund të zgjidhen sërish drejtpërdrejt.

(3) Secili prej anëtarëve të Këshillit të Sigurimit ka këtu një pëfaqësues të tijin.

Neni 24

(1) Për të garantuar një veprim të shpejtë dhe të efektshëm të Kombeve të Bashkuara anëtarët e tyre ia kalojnë Këshillit të Sigurimit përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare si dhe njohin faktin, që Këshilli i Sigurimit gjatë realizimit të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo përgjegjësi, vepron në emrin e Kombeve të Bashkuara.

(2) Gjatë përmushjes së këtyre detyrimeve Këshilli i Sigurimit vepron në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara. Kompetencat, që atij i njihen në këtë kontekst, sqarohen në kapitujt VI, VII, VIII dhe XII.

(3) Këshilli i Sigurimit i paraqet për shqyrtim Asamblesë së Përgjithshme raportet vjetore dhe, në rast se duhet, edhe raporte të veçanta.

Neni 25

Anëtarët e Kombeve të Bashkuara bien dakord të pranojnë dhe zbatojnë vendimet e Këshillit të Sigurimit në përputhje me këtë Kartë.

Neni 26

Me qëllim që vendosja dhe ruajtja e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare të mbështeten në mënyrë të tillë, që për qëllime armatimi të përdoren sa më pak nga burimet njerëzore dhe ekonomike në botë, Këshilli i Sigurimit ngarkohet, që ,me mbështetjen e Komisionit të Shtabit të Përgjithshëm parashikuar në nenin 47 të hartojë plane, të cilat u duhen parashtruar Kombeve të Bashkuara me qëllim ngritjen e një sistemi rregullash në lidhje me armatimin.

Votimi

Neni 27

(1) Secili prej anëtarëve të Këshillit të Sigurimit ka një votë.

(2) Për vendimet e Këshillit të Sigurimit në lidhje me çështje procedurale nevojitet miratimi i nëntë anëtarëve.

(3) Për vendimet e Këshillit të Sigurimit në lidhje me të gjitha çështjet e tjera nevojitet miratimi i nëntë anëtarëve përfshirë edhe të gjithë anëtarët e përhershëm, gjithsesi duke iu përmbajtur kushtit, që në rast vendimesh në bazë të kapitullit VI dhe nenit 52, kreu 3, palët në konflikt duhet të abstenojnë.

Procedura

Neni 28

(1) Këshilli i Sigurimit organizohet në mënyrë të tillë që të mundë të realizojë në mënyrë të vazhdueshme detyrat e tij. Secili prej anëtarëve të tij duhet, që për këtë qëllim të jetë i përfaqësuar në selinë e organizatës

(2) Këshilli i Sigurimit mblidhet në seanca të rregullta mbledhjesh; këtu mund të përfaqësohet secili prej anëtarëve të tij sipas dëshirës nga një anëtar qeverie ose nga një i deleguar i tij për këtë qëllim.

(3) Këshilli i Sigurimit ,përveç se në selinë e organizatës, mund të mblidhet edhe në vende të tjera, nëse ai do të gjykonte se kjo do t'i shërbente më mirë punës së tij.

Neni 29

Këshilli i Sigurimit mund të vërë në veprim organe dytësore, nëse ai do ta konsideronte këtë si të domosdoshme për realizimin e detyrave të tij.

Neni 30

Këshilli i Sigurimit vendos një rend aktiviteti; në këtë mënyrë ai rregullon edhe procedurat për zgjedhjen e presidentit të tij.

Neni 31

Një anëtar i Kombeve të Bashkuara, i cili nuk është anëtar i Këshillit të Sigurimit, mund të marrë pjesë pa të drejtë vote në diskutimin e çdo çështjeje paraqitur Këshillit të Sigurimit, nëse ky i fundit mendon, se interesat e këtij anëtar janë prekur në mënyrë të veçantë.

Neni 32

Anëtarët e Kombeve të Bashkuara, që nuk janë anëtarë të Këshillit të Sigurimit, si dhe shtete jo-anëtare të Kombeve të Bashkuara ftohen të marrin pjesë pa të drejtë vote në diskutimet e Këshillit të Sigurimit në lidhje me një konflikt, me të cilin merret ky i fundit, nëse këto shtete janë palë në konflikt. Për pjesëmarrjen e një shteti jo-anëtar të Kombeve të Bashkuara Këshilli i Sigurimit përcakton kushte, që ai i konsideron të drejta.

[\[Permbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli VI: Zgjidhja paqësore e konflikteve**Neni 33**

(1) Palët e një konflikti, vijimi i të cilit mund të rrezikojë ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare përpiqen fillimisht të arrijnë në një zgjidhje të konfliktit me anë bisedimesh, analizash, ndërmjetësimesh, gjykimesh, vendimesh gjyqësore, përfshirjes së institucioneve rajonale ose marrëveshesh ose përmes mjeteve të tjera paqësore në zgjedhjen e palëve.

(2) Këshilli i Sigurimit, në rast se e konsideron të nevojshme, u bën apel palëve, të zgjidhin konfliktet e tyre përmes mjeteve të tilla.

Neni 34

Këshilli i Sigurimit mund të marrë në shqyrtim çdo konflikt apo situatë, që mund të bëhet shkak fërkimesh ndërkombëtare ose konfliktesh të ndryshme, për të përcaktuar, nëse vijimi i konfliktit apo situatës në fjalë, do të mund të rrezikonte ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Neni 35

(1) Secili prej anëtarëve të Kombeve të Bashkuara mund të sjellë në vëmendjen e Këshillit të Sigurimit ose Asamblesë së Përgjithshme çdo konflikt apo situatë përcaktuar në nenin 34.

(2) Një shtet jo-anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të sjellë në vëmendjen e Këshillit të Sigurisë ose të Asamblesë së Përgjithshme çdo konflikt apo situatë,

palë e të cilit /së cilës ai është, nëse ai pranon detyrimet e përcaktuara në këtë kartë në lidhje me zgjidhjen paqësore të këtij konflikti.

(3) Mënyra e të proceduarit të Asamblesë së Përgjithshme në çështje, në lidhje me të cilat tërhiqet vëmendja sikurse parashikohet në këtë nen, përcaktohet sipas neneve 11 dhe 12.

Neni 36

(1) Këshilli i Sigurimit mund të rekomandojë në çdo stad të një konflikti në kuptimin e nenit 33 ose të një situate të së njëjtës natyrë, procedura apo metoda të përshtatshme për zgjidhjen e tyre.

(2) Këshilli i Sigurimit duhet të marrë në konsideratë të gjitha procedurat, që palët kanë pranuar tashmë për zgjidhjen e konfliktit.

(3) Gjatë rekomandimeve të tij sipas këtij neni, Këshilli i Sigurimit duhet të ketë parasysh, që konfliktet ligjore, në përgjithësi, i duhen paraqitur Gjykatës Ndërkombtare nga palët në përputhje me statutin e tij.

Neni 37

(1) Nëse palët e një konflikti, në kuptimin e nenit 33, nuk arrijnë në një zgjidhje me mjetet e përshkruara në këtë nen, ato ia parashtrajnë konfliktin Këshillit të Sigurimit.

(2) Nëse, sipas gjykimit të Këshillit të Sigurisë, vijimi i konfliktit do të përbente një rrezik faktik për ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare, atëherë ai vendos, nëse do të veprojë sipas nenit 36 apo do të japë ato rekomandime, sipas tij të përshtatshme për zgjidhjen e konfliktit.

Neni 38

Pavarësisht neneve 33 deri 37, Këshilli i Sigurimit mund t'u drejtojë rekomandimet e tij palëve në konflikt për një zgjidhje paqësore të këtij të fundit, nëse të gjitha palët e konfliktit e kërkojnë këtë.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli VII: Masa në rast kërcënimi apo shkeljeje të paqes si dhe në rast veprimesh mësymëse.

Neni 39

Këshilli i Sigurimit është ai, që përcakton, nëse kemi të bëjmë me një kërcënim ose prishje të paqes ose sulm; ai jep rekomandimet e tij dhe vendos se cilat masa duhen marrë sipas neneve 41 dhe 42, për të ruajtur ose për të rivendosur paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare.

Neni 40

Për të parandaluar një rëndim të gjendjes, Këshilli i Sigurimit, përpara se të japë rekomandime sipas nenit 39 apo të vendosë masa, mund t'u kërkojë palëve të ndjekin masat e përkohëshme vlerësuar prej tij si të nevojshme ose të dëshirueshme. Këto masa të përkohëshme nuk i prekin të drejtat, pretendimet dhe pozicionin e palëve pjesëmarrëse. Nëse këto masa të përkohëshme nuk ndiqen,

atëherë Këshilli i Sigurimit do të mbajë përgjegjësinë përkatëse për këtë dështim të tijin.

Neni 41

Këshilli i Sigurimit mund të vendosë, se cilat masa duhen marrë – duke përjashtuar ndërhyrjen me armë – në mënyrë, që vendimet e tij të bëhen të efektshme; ai mund t'u kërkojë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, të realizojnë këto masa. Këtu përfshihen ndërprerjet e plotë ose të pjesshme të marrëdhënieve ekonomike, të transportit hekurudhor, ujor dhe ajror, të lidhjeve postare, telegrafike dhe me radiomarrëse dhe të mundësive të tjera të qarkullimit si dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike.

Neni 42

Nëse Këshilli i Sigurimit është i mendimit, se masat e parashikuara në nenin 41 do të jenë të pamjaftueshme ose nëse ato kanë rezultuar si të tilla, atëherë ai mund të realizojë masat e nevojshme për ruajtjen apo rivendosjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare duke përdorur forcat e armatosura tokësore, ajrore dhe ujore. Në këto masa përfshihen demonstrimet e forcës, bllokada dhe angazhime të tjera të forcave të armatosura tokësore, ajrore dhe ujore.

Neni 43

(1) Të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara marrin përsipër të kontribuojnë në ruajtjen e paqes botërore duke vënë në dispozicion, me kërkesën e Këshillit të Sigurisë, sipas përcaktimeve të një apo disa marrëveshjeve lidhur me këtë të fundit, trupat e tyre të armatosura, duke ofruar mbështetjen e tyre dhe lehtësira të tjera deri edhe marshimin e trupave, për sa kohë që kjo është e nevojshme për ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare.

(2) Këto marrëveshje duhet të parashikojnë numrin dhe llojin e trupave, nivelin e gatishmërisë së tyre, vendndodhjen e tyre të përgjithshme si dhe llojin e asistencës dhe të lehtësirave.

(3) Me iniciativën e Këshillit të Sigurimit këto marrëveshje përfundohen sa më shpejt të jetë e mundur nëpërmjet bisedimesh. Ato lidhen mes Këshillit të Sigurimit nga njëra anë dhe anëtarëve të veçantë apo grupesh anëtarësh nga ana tjetër dhe nënshkruhen nga shtetet nënshkruese sipas ligjit të tyre kushtetues.

Neni 44

Nëse Këshilli i Sigurimit ka vendosur përdorimin e dhunës, ai fton një anëtar, që nuk ka përfaqësues në këtë Këshill, që të marrë pjesë me dëshirën e tij në vendimet mbi hedhjen në veprim të kontingjenteve të forcave të armatosura të këtij anëtari, përpara se t'ia kërkojë këtë bazuar në detyrimet e marra përsipër me anë të nenit 43.

Neni 45

Që Kombet e Bashkuara të jenë të afta të realizojnë ndërhyrje urgjente ushtarake, anëtarët e kësaj Organizate i mbajnë kontingjentet e tyre të Forcave të armatosura ajrore gati për hedhje në veprim në kuadër të masave detyruese të përbashkëta ndërkombëtare. Potencialin dhe nivelin e gatishmërisë së këtyre kontingjenteve si dhe planet për masat e tyre të përbashkëta i përcakton Këshilli i Sigurimit me mbështetjen e Komisionit të Shtabit të Përgjithshëm në kuadër të

marrëveshjeve të veçanta të përmendura në nenin 43.

Neni 46

Planet për përdorimin e armëve përgatiten nga Këshilli i Sigurimit me mbështetjen e Komisionit të Shtabit të Përgjithshëm.

Neni 47

(1) Komisioni i Shtabit të Përgjithshëm funksionon për të këshilluar dhe mbështetur Këshillin e Sigurimit në të gjitha ato çështje, që kanë të bëjnë me nevojat e tij ushtarake për mbrojtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare, hedhjen në veprim dhe udhëheqjen e forcave të armatosura, vënë në dispozicion Këshillit të Sigurimit, si dhe me rregulloren e armatimit dhe çarmatimin eventual.

(2) Komisioni i Shtabit të Përgjithshëm përbëhet nga shefat e shtabeve të përgjithshëm të shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit ose nga përfaqësuesit e tyre. Një anëtar i Kombeve të Bashkuara, i përfaqësuar jo në mënyrë të përhershme në Komision, ftohet nga ky i fundit, që t'i bashkangjitet atij, nëse bashkëpunimi i këtij anëtari është i nevojshëm për realizimin e suksesshëm të detyrave të komisionit.

(3) Komisioni i Shtabit të Përgjithshëm, nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit, është përgjegjës për udhëheqjen strategjike të të gjitha forcave të armatosura, që i janë vënë në dispozicion Këshillit të Sigurimit. Çështje rreth udhëheqjes së këtyre forcave të armatosura rregullohen më vonë.

(4) Komisioni i Shtabit të Përgjithshëm, me autorizimin e Këshillit të Sigurimit dhe pas konsultimesh me institucionet përkatëse vendase, mund të vërë në veprim nënkomisionet rajonale.

Neni 48

(1) Masat e domosdoshme për realizimin e vendimeve të Këshillit të Sigurimit për mbrojtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare merren nga të gjithë ose nga disa anëtarë të Kombeve të Bashkuara pas dhënies së vlerësimit nga Këshilli i Sigurimit.

(2) Këto vendime realizohen drejtpërdrejt nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara si dhe përmes masave të marra nga institucionet përkatëse ndërkombëtare, anëtarë të të cilave ato janë.

Neni 49

Gjatë realizimit të masave të vendosura nga Këshilli i Sigurimit anëtarët e Kombeve të Bashkuara asistojnë bashkarisht njëri-tjetrit në mënyrë aktive.

Neni 50

Nëse Këshilli i Sigurimit merr masa parandaluese ose shtrënguese ndaj një shteti, çdo shtet tjetër, anëtar ose jo i Kombeve të Bashkuara, të cilin realizimi i këtyre masave e vendos përpara problemesh të veçanta ekonomike, konsultohet me Këshillin e Sigurimit për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Neni 51

Në rast të një sulmi të armatosur kundër një anëtar të Kombeve të Bashkuara, kjo Kartë nuk bie absolutisht ndesh me të drejtën natyrore të vetëmbrojtjes individuale apo kolektive, deri sa Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare. Masat, që një anëtar merr gjatë ushtrimit të së drejtës së tij për vetëmbrojtje, i duhen bërë menjëherë të ditura Këshillit të Sigurimit; ato nuk prekin asses plotfuqinë dhe detyrimin e këtij Këshilli, që burojnë nga kjo Kartë, për të marrë në çdo moment masat, që ai i konsideron të domosdoshme për ruajtjen ose rivendosjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli VIII: Marrëveshjet rajonale

Neni 52

(1) Kjo Kartë nuk e përjashton ekzistencën e marrëveshjeve rajonale për trajtimin e atyre çështjeve, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare, në kuadër të të cilave merren masa të natyrës rajonale; kusht paraprak për këtë është, që këto marrëveshje ose institucione dhe efekti i tyre të përputhen me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

(2) Anëtarët e Kombeve të Bashkuara, që lidhin të tilla marrëveshje apo ngrenë të tilla institucione, përpiqen me të gjitha mundësitë e tyre, që duke iu referuar këtyre marrëveshjeve ose institucioneve rajonale të zgjidhin në mënyrë paqësore konfliktet e kufizuara nga pikëpamja lokale, përpara se me to të merret Këshilli i Sigurimit.

(3) Këshilli i Sigurimit mbështet zhvillimin e procedurave për zgjidhjen paqësore të konflikteve të kufizuara nga pikëpamja lokale duke iu referuar këtyre marrëveshjeve ose institucioneve rajonale, qoftë kjo me iniciativën e shteteve pjesëmarrëse, qoftë me udhëzimet e vetë Këshillit të Sigurimit.

(4) Zbatimi i neneve 34 dhe 35 nuk preket nga ky nen.

Neni 53

(1) Këshilli i Sigurimit u referohet këtyre marrëveshjeve ose institucioneve rajonale, nëse duhet, për realizimin e masave shtrënguese nën autoritetin e tij. Pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit nuk mund të merren masa detyruese parashikuar në marrëveshje rajonale apo nga ana e institucioneve rajonale; këtu përjashtohen masat kundër një shteti armik në kuptimin e kreut 2, nëse këto janë të parashikuara në nenin 107 apo në marrëveshje rajonale, të lidhura për t'iu kundërvënë ushtrimit të një politike mësymëse nga një shtet i tillë; ky përjashtim vlen derisa organizatës, me kërkesë të qeverive pjesëmarrëse, t'i caktohet detyra të pengojë sulmet e reja të një shteti të tillë.

(2) Me termin "shtet armik" në kreun 1 cilësohet secili prej shteteve, që gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte armik i nënshkruesve të kësaj Karte.

Neni 54

Këshilli i Sigurimit duhet informuar vazhdimisht dhe në mënyrë të plotë në lidhje me masat , që janë marrë apo mendohet të merren në bazë marrëveshjesh rajonale apo nga institutionet rajonale me qëllim ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli IX: Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën ekonomike dhe sociale

Neni 55

Për të krijuar atë gjendje stabiliteti dhe mirëqënieje, që është e nevojshme në mënyrë që mes kombeve të mbizotërojnë marrëdhënie paqësore dhe miqësore, të cilat bazohen në respektimin e parimeve të barazisë dhe të vetëvendosjes, Kombet e Bashkuara mbështesin:

- a) përmirësimin e standardeve të jetesës, punësimin e plotë dhe krijimin e kushteve për progres dhe rritje ekonomike e sociale;
- b) zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, shëndetësore dhe të ngjashme me to si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e kulturës dhe edukimit;
- c) respektimin e përgjithshëm dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, gjuhe dhe besimi fetar.

Neni 56

Të gjitha shtetet anëtare marrin përsipër, të bashkëpunojnë në grup dhe veçmas me organizatën për të arritur qëllimet e përshkruara në nenin 55.

Neni 57

(1) Organizatat e veçanta, të cilat janë ngritur në bazë marrëveshjesh ndërshtetërore dhe që synojnë përmbushjen e një sërë detyrash ndërkombëtare në fushat ekonomike, sociale, kulturore, edukative, shëndetësore dhe të tjera të ngjashme me to, përshkruar këto në dokumenta detyruese, e krijojnë raportin me Kombet e Bashkuara siç parashikohet në nenin 63.

(2) Këto organizata, që kanë vendosur lidhjen e tyre me Kombet e Bashkuara, më poshtë do të quhen „Organizata të posaçme“.

Neni 58

Organizata e Kombeve të Bashkuara jep rekomandime për të koordinuar objektivat dhe veprimtaritë e Organizatave të Posaçme.

Neni 59

Organizata e Kombeve të Bashkuara inicion, në rast se duhet, bisedime mes shteteve përkatëse me qëllim ngritjen e një Organizate të Posaçme të re, nëse kjo do të ishte e nevojshme për realizimin e objektivave përcaktuar në nenin 55

Neni 60

Për realizimin e detyrave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, përmendur në këtë kapitull, është përgjegjëse Asambleja e Përgjithshme dhe, nënvendosur asaj, Këshilli Ekonomik dhe Social; ky i fundit zotëron për këtë qëllim kompetencat, që i njihen atij në Kapitullin X.

Kapitulli X: Këshilli Ekonomik dhe Social

Përbërja

Neni 61

(1) Këshilli Ekonomik dhe Social përbëhet nga pesëdhjetë e katër anëtarë të Kombeve të Bashkuara, zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.

(2) Me kusht respektimin e paragrafit 3, çdo vit zgjidhen tetëmbëdhjetë anëtarë të Këshillit Ekonomik dhe Social me një mandat 3-vjeçar. Një anëtar, të cilit i ka mbaruar mandati, mund të zgjidhet menjëherë sërish.

(3) Gjatë zgjedhjeve të para pas rritjes së numrit të anëtarëve të Këshillit nga njëzeteshtatë në pesëdhjetëkatër, përveç anëtarëve, që do të zgjidhen në vend të nëntë anëtarëve, mandati i të cilëve mbaron me vitin përkatës, do të zgjidhen edhe njëzet e shtatë anëtarë të tjerë të Këshillit Ekonomik dhe Social. Mandati zyrtar i nëntë prej këtyre njëzeteshtatë anëtarëve shtesë mbaron pas një viti, ndërsa ai i nëntë anëtarëve të tjerë pas dy vitesh; çështje të tjera rregullohen nga Asambleja e Përgjithshme.

(4) Çdo anëtar i Këshillit Ekonomik dhe Social ka në këtë Këshill një përfaqësues të tijin.

Detyrat dhe kompetencat

Neni 62

(1) Këshilli Ekonomik dhe Social mund të marrë në analizë apo të iniciojë analizën e çështjeve ndërkombtare në fushat e ekonomisë, sistemit social, kulturës, edukimit dhe shëndetësisë si dhe në fusha të tjera të ngjashme me to, ose të hartojë apo të iniciojë hartimin e raporteve përkatëse; në lidhje me çdo çështje të tillë ai mund t'i japë rekomandime Asamblesë së Përgjithshme, anëtarëve të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të posaçme përkatëse.

(2) Ai mund të japë rekomandime për të mbështetur respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë.

(3) Në lidhje me çështje, që janë kompetencë e tij, ai mund të hartojë marrëveshje dhe t'ia paraqesë ato Asamblesë së Përgjithshme.

(4) Ai mund edhe të thërrasë konferenca ndërkombëtare në lidhje me çështje, që janë kompetencë e tij, gjithnjë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Kombet e Bashkuara.

Neni 63

(1) Këshilli Ekonomik dhe Social mund të lidhë marrëveshje me secilën prej organizatave të posaçme, përcaktuar në nenin 57, marrëveshje këto ku rregullohen marrëdhëniet e organizatave përkatëse me Kombet e Bashkuara. Për këto marrëveshje nevojitet miratimi i Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Ai mund të koordinojë veprimtarinë e organizatave të posaçme duke realizuar

me to konsultime si dhe duke iu drejtuar atyre, Asamblesë së Përgjithshme dhe anëtarëve të Kombeve të Bashkuara rekomandimet e tij.

Neni 64

(1) Këshilli Ekonomik dhe Social mund të ndërmarrë hapa të përshtatshëm, në mënyrë që të marrë nga organizatat e posaçme raporte periodike. Ai mund të lidhë marrëveshje me anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe me organizatat e posaçme, në mënyrë që të marrë prej tyre raporte në lidhje me masat e marra për realizimin e rekomandimeve të tij dhe të rekomandimeve të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me çështje, që janë kompetencë e tij.

(2) Ai mund të informojë Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me vërejtjet e tij mbi këto raporte.

Neni 65

Këshilli Ekonomik dhe Social mund t'i japë informacione Këshillit të Sigurimit dhe ta mbështesë atë, me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 66

(1) Këshilli Ekonomik dhe Social realizon të gjitha detyrat, të cilat janë kompetencë e tij lidhur edhe me zbatimin e rekomandimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme ai mund të kryejë të gjitha shërbimet, që i kërkohen nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara apo organizatat e posaçme.

(3) Ai realizon edhe të gjitha detyrat e tjera, që i takojnë atij sipas kësaj Karte apo që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Votimi

Neni 67

(1) Secili prej anëtarëve të Këshillit Ekonomik dhe Social ka një votë.

(2) Vendimet e Këshillit Ekonomik dhe Social merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm votues.

Procedura

Neni 68

Këshilli Ekonomik dhe Social aktivizon komisionet për çështje ekonomike dhe sociale dhe për mbështetjen të drejtave të njeriut si dhe të gjitha komisionet e tjera të nevojshme për realizimin e detyrave të tij.

Neni 69

Nëse Këshilli Ekonomik dhe Social trajton një çështje, që për një anëtar të Kombeve të Bashkuara është me rëndësi të veçantë, atëherë ai e fton atë të marrë pjesë në seancat e konsultimeve pa të drejtë vote.

Neni 70

Këshilli Ekonomik dhe Social mund të lidhë marrëveshje të tilla, që përfaqësues të organizatave të posaçme të marrin pjesë pa të drejtë vote në seancat e tij të konsultimeve dhe në ato të komisioneve të aktivizuara prej tij, si dhe që përfaqësuesit e tij të marrin pjesë në seancat e konsultimeve të organizatave të posaçme.

Neni 71

Këshilli Ekonomik dhe Social mund të lidhë marrëveshje të përshtatshme me qëllim konsultimin me organizata jo-qeveritare, që merren me çështje të kompetencës së tij. Marrëveshje të tilla mund të lidhen me organizata ndërkombëtare dhe, për sa kohë që është e përshtatshme, edhe me organizata kombëtare, pasi anëtari përkatës i Kombeve të Bashkuara të jetë konsultuar në lidhje me këtë.

Neni 72

(1) Këshilli Ekonomik dhe Social vendos rendin e aktivitetit të tij; këtu ai përcakton edhe procedurat për zgjedhjen e presidentit të tij.

(2) Këshilli Ekonomik dhe Social mbledhet sipas nevojës në përputhje me rendin e aktivitetit të tij; në këtë të fundit parashikohet edhe thirrja e seancave me kërkesën e shumicës së anëtarëve të tij.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XI: Deklaratë mbi territoret shtetërore pa vetëqeverisje

Neni 73

Anëtarët e Kombeve të Bashkuara, që kanë apo marrin përsipër përgjegjësinë për administrimin e territoreve shtetërore, popujt e të cilave nuk kanë arritur ende vetëqeverisjen e plotë, njohin parimin, sipas të cilit interesat e banorëve të këtyre territoreve shtetërore kanë përparësi; ata marrin përsipër si një detyrë të shenjtë detyrimin, që, në kuadër të sistemit të paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare, ngritur përmes kësaj Karte, të mbështesin maksimalisht të mirën e këtyre banorëve. Për këtë qëllim ata marrin përsipër,

a) të garantojnë progresin politik, ekonomik, social dhe arsimor, trajtimin e drejtë dhe mbrojtjen e këtyre popujve nga abuzimet duke treguar respektin e duhur përkundrejt kulturës së tyre;

b) të zhvillojnë vetëqeverisjen, të marrin në konsideratë, sikurse duhet, synimet politike të këtyre popujve dhe t'i mbështesin ata gjatë zhvillimit progresiv të institucioneve të tyre të lira politike, dhe kjo në përputhje me raportet e veçanta të çdo territori shtetëror, të popullsisë së tij dhe të nivelit përkatës të zhvillimit;

c) të konsolidojnë paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare;

d) të nxisin masat për ndërtim dhe zhvillim, të mbështesin veprimtarinë kërkimore si dhe të bashkëpunojnë me njëri tjetrin, e në rast se duhet edhe me organizatat ndërkombëtare të specialitetit, në mënyrë që të realizojnë kështu qëllimet sociale, ekonomike dhe shkencore përcaktuar me këtë nen;

e) t'i përcjellë rregullisht për njoftim Sekretarit të Përgjithshëm, duke respektuar kufizimet, që marrin në konsideratë sigurinë dhe kushtetutën, informacione statistikore dhe informacione të tjera të natyrës teknike në lidhje me sistemin ekonomik, social dhe arsimor në territoret shtetërore, që nuk përcaktohen në kapitujt XII dhe XIII, territore këto për të cilat ata mbajnë përgjegjësi.

Neni 74

Anëtarët e Kombeve të Bashkuara bien dakord, që politika e ndjekur prej tyre për territoret shtetërore, që përcaktohen në këtë kapitull, të mbështetet në parimin e përgjithshëm të fqinjësisë së mirë në çështje sociale, ekonomike dhe tregtare jo më pak sesa politika që ata ndjekin në vendet e tyre; këtu duhen marrë në konsideratë sikurse duhet interesat dhe mirëqenia e pjesës tjetër të botës.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XII: Sistemi nërkombtar i kujdestarisë

Neni 75

Kombet e Bashkuara ngrenë me autoritetin e tyre një sistem ndërkombëtar mirëbesimi/kujdestarie për administrimin dhe mbikqyrjen e territoreve shtetërore, që do t'i bashkohen këtij sistemi në kuadrin e marrëveshjeve të mëpasshme individuale. Këto territore shtetërore më poshtë do t'i quajmë territore nën kujdestari.

Neni 76

Në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Karte Sistemi i Kujdestarisë u shërben kryesisht këtyre qëllimeve:

- a) konsolidon paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare;
- b) nxit progresin politik, ekonomik, social dhe arsimor të banorëve të territoreve nën kujdestari si dhe zhillimin progresiv deri në vetëqeverisje apo pavarësi duke u korresponduar raporteve të veçanta të seciles prej këtyre territoreve nën kujdestari dhe popullsisë së tyre si dhe dëshirave të tyre të shprehura lirshëm, e, më pas, sikurse është parashikuar në marrëveshjen e kujdestarisë përkatëse;
- c) nxit respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive të tij themelore për të gjithë pa dallim race, gjinie, gjuhe apo besimi fetar si dhe përforcon vetëdijen e varësisë së ndërsjellë të popujve të botës;
- d) garanton trajtimin e barabartë të të gjithë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara dhe shtetasve të tyre në çështje sociale, ekonomike dhe tregtare si dhe trajtimin e barabartë të këtyre nënshtetasve përballë ligjit, pa lënë pas dore realizimin e qëllimeve të përmendura më sipër; neni 80 mbetet i paprekur.

Neni 77

(1) Sistemi i kujdestarisë gjen zbatim në territoret shtetërore, që u përkasin grupeve të mëposhtme, nëse ato përfshihen në këtë sistem me anë marrëveshjesh kujdestarie:

- a) territore të mandatuara aktualisht ekzistuese;

b) territore shtetërore, të ndara nga shtetet armike si pasojë e Luftës së Dytë Botërore;

c) territore shtetërore, të cilat bëhen vullnetarisht pjesë e sistemit nga shtetet që janë përgjegjëse për administrimin e tyre.

(2) Përcaktimi, se cilat territore shtetërore nga grupet e përmendura bëhen pjesë e sistemit të kujdestarisë dhe cilat janë dispozitat përkatëse, mbetet për tu vendosur në një marrëveshje tjetër.

Neni 78

Sistemi i kujdestarisë nuk gjen zbatim në ato territore shtetërore, që janë bërë anëtare të Kombeve të Bashkuara; marrëdhëniet mes anëtarëve mbështeten në respektin e parimit të barazisë sovrane.

Neni 79

Për çdo territor shtetëror, që do të bëhet pjesë e sistemit të kujdestarisë lidhet një marrëveshje mbi dispozitat e kujdestarisë përfshirë këtu të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e shteteve direkt pjesëmarrëse, ku – në rastin e një territori të mandatuar të një anëtari të Kombeve të Bashkuara - bën pjesë edhe dhënësi i mandatit; për këtë nevojitet miratimi sipas neneve 83 dhe 85.

Neni 80

(1) Për sa kohë që në marrëveshjet e veçanta të kujdestarisë, lidhur sipas neneve 77, 79 dhe 81 mbi përfshirjen e një territori në Sistemin e Kujdestarisë nuk është rënë dakord për të tjera gjëra dhe për sa kohë që marrëveshje të tilla nuk janë lidhur ende, ky kapitull nuk duhet interpretuar në mënyrë të tillë, sikur ai ndryshon drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtat e shteteve ose popujve ose marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi, palët kontraktuese të cilave janë anëtarët e Kombeve të Bashkuara.

(2) Nga kreu 1 nuk rezulton ndonjë justifikim për vonesat apo shtyrjet e bisedimeve për marrëveshjet mbi përfshirjen e territoreve të mandatuar apo territoreve të tjera shtetërore, sikurse parashikohet në nenin 77, apo vonesat dhe shtyrjen e lidhjes së këtyre marrëveshjeve.

Neni 81

Çdo marrëveshje kujdestarie përmban dispozitat, sipas të cilave duhet administruar një territor shtetëror, dhe cilëson edhe autoritetin administrativ. Ky i fundit, që më poshtë do të quhet "Pushtet administrativ", mund të jetë një shtet, një grup shtetesh ose vetë organizata.

Neni 82

Çdo marrëveshje kujdestarie mund të cilësojë një ose disa zona strategjike, të cilat përmbledhin të gjithë territorin nën kujdestari, për të cilin është e vlefshme marrëveshja, ose edhe një pjesë të tij; marrëveshjet e posaçme sipas nenit 43 mbeten të paprekura.

Neni 83

(1) Të gjitha detyrat e Kombeve të Bashkuara lidhur me zonat strategjike,

përfshirë këtu miratimin e marrëveshjeve të kujdestarisë si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre, realizohen nga Këshilli i Sigurimit.

(2) Objektivat kryesorë përcaktuar në nenin 76 vlejnë edhe për popullsinë e çdo zone strategjike.

(3) Duke iu referuar marrëveshjeve të kujdestarisë si dhe me kusht respektimin e kërkesave të sigurisë Këshilli i Sigurimit kërkon mbështetjen e Këshillit të Kujdestarisë, në mënyrë që, në kuadër të sistemit të kujdestarisë të mund të realizojë ato detyra të Kombeve të Bashkuara, që kanë të bëjnë me çështje politike, ekonomike, sociale dhe arsimore në zonat strategjike.

Neni 84

Pushteti administrativ duhet të kujdeset, që territoret nën kujdestari të japin kontributin e tyre për ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare. Për këtë qëllim ai mund të marrë në konsideratë forcat vullnetare të armatosura, lehtësirat dhe asistencën e zonës nën kujdestari, për të përmbushur detyrimet, që ai ka marrë përsipër kundrejt Këshillit të Sigurimit si dhe për të garantuar mbrojtjen lokale dhe ruajtjen e ligjit dhe të së drejtës dhe rendit brenda territorit nën kujdestari.

Neni 85

(1) Detyrat e Kombeve të Bashkuara në kuadër të marrëveshjeve të kujdestarisë për të gjitha ato territore, që nuk cilësohen si zona strategjike, përfshirë këtu edhe miratimin e marrëveshjeve të kujdestarisë si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre, realizohen nga Asambleja e Përgjithshme.

(2) Gjatë realizimit të këtyre detyrave Asambleja e Përgjithshme mbështetet nga Këshilli i Kujdestarisë, i cili vepron nën autoritetin e saj.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XIII: Këshilli i Kujdestarisë

Përbërja

Neni 86

(1) Këshilli i Kujdestarisë përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm të Kombeve të Bashkuara:

- a) Anëtarët, që administrojnë territoret nën kujdestari;
- b) Anëtarët e përmendur shprehimisht në nenin 23, për sa kohë që nuk administrojnë territore nën kujdestari;
- c) aq anëtarë të tjerë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, sa të jetë e nevojshme, që Këshilli i Kujdestarisë të përbëhet në gjysmën e tij nga anëtarë të Kombeve të Bashkuara, të cilët administrojnë territore nën kujdestari, dhe në gjysmën tjetër nga anëtarë të tillë, që nuk administrojnë territore nën kujdestari.

(2) Çdo anëtar i Këshillit të Kujdestarisë ngarkon një person veçanërisht të përshtatshëm, për ta përfaqësuar atë në këtë Këshill.

Detyrat dhe kompetencat

Neni 87

Asambleja e Përgjithshme dhe, nën autoritetin e saj, edhe Këshilli i Kujdestarisë, gjatë realizimit të detyrave të tyre mund të

- a) analizojnë raportet e paraqitura nga pushteti administrativ;
- b) pranojnë kërkesa dhe t'i shqyrtojnë ato duke u konsultuar me pushtetin administrativ;
- c) iniciojnë vizita periodike në territore të veçanta nën kujdestari, për momentin kohor të të cilave bihet dakord me pushtetin administrativ;
- d) marrin këto masa dhe të tjera në përputhje me marrëveshjet e kujdestarisë.

Neni 88

Këshilli i Kujdestarisë harton një pyetësor në lidhje me progresin politik, ekonomik, social dhe arsimor të çdo territori nën kujdestari; pushteti administrativ i secilit prej territoreve nën kujdestari, për të cilin është kompetente Asambleja e Përgjithshme, paraqet një raport të përvitshëm në bazë të këtij pyetësori.

Votimi

Neni 89

- (1) Secili prej anëtarëve të Këshillit të Kujdestarisë ka një votë.
- (2) Vendimet e Këshillit të Kujdestarisë kërkojnë shumicën e anëtarëve të pranishëm votues.

Procedura

Neni 90

- (1) Këshilli i Kujdestarisë vendos rendin e aktivitetit të tij; këtu ai përcakton edhe procedurat për zgjedhjen e presidentit të tij.
- (2) Këshilli i Kujdestarisë mbledhet sipas nevojës në përputhje me rendin e aktivitetit të tij; në këtë të fundit parashikohet edhe thirrja e seancave me kërkesën e shumicës së anëtarëve të tij.

Neni 91

Këshilli i Kujdestarisë kërkon, në rast se duhet, edhe mbështetjen e Këshillit Ekonomik dhe Social për çështje, që janë kompetencë e tij.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XIV: Gjykata Ndërkombëtare

Neni 92

Gjykata Ndërkombëtare është organi më i rëndësishëm juridik i Kombeve të Bashkuara. Ai realizon detyrat e tij sikurse parashikohet në statutin bashkëngjitur, i cili bazohet në statutin e Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare dhe është pjesë përbërëse e kësaj Karte.

Neni 93

(1) Të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara janë palë kontraktore të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare.

(2) Një shtet, që nuk është anëtar i Kombeve të Bashkuara, mund të bëhet palë kontraktore e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare, në rast se plotëson kushtet që vendos Asambleja e Kombeve të Bashkuara me rekomandim të Këshillit të Sigurimit.

Neni 94

(1) Secili prej anëtarëve të Kombeve të Bashkuara merr përsipër, që në çdo rast konflikti, palë e të cilit është edhe ai, të respektojë vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare.

(2) Nëse një palë konflikti nuk i respekton detyrimet, që rrjedhin nga një vendim Gjykate, pala tjetër mund tjetër mund t'i drejtohet Këshillit të Sigurimit; ky, në rast se e konsideron të nevojshme, mund të japë rekomandime ose të marrë masa për të siguruar efektshmërinë e vendimit.

Neni 95

kjo Kartë nuk e përjashton mundësinë, që anëtarët e Kombeve të Bashkuara në bazë të marrëveshjeve ekzistuese apo të ardhshme t'u drejtohen Gjykatave të tjera për zgjidhjen e konflikteve të tyre.

Neni 96

(1) Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli i Sigurimit mund të kërkojë për çdo çështje juridike vlerësimin e Gjykatës Ndërkombëtare.

(2) Organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, pasi marrin autorizimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme, mund t'i kërkojnë Gjykatës opinione në lidhje me çështje juridike, që kanë të bëjnë me fushën e tyre të veprimtarisë.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XV: Sekretaria

Neni 97

Sekretariati përbëhet nga një Sekretar i Përgjithshëm dhe nga punonjësit e tjerë, për të cilët ka nevojë organizata. Sekre tarii Përgjithshëm caktohet nga Asambleja e Përgjithshme me rekomandim të Këshillit të Sigurimit. Ai është nëpunësi më i lartë administrativ i organizatës.

Neni 98

Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në këtë cilësi në të gjitha sesionet e Asamblesë së Përgjithshme, të Këshillit të Sigurimit, të Këshillit Ekonomik dhe

Social dhe të Këshillit të Kujdestarisë si dhe realizon të gjitha detyrat, që i caktohen atij nga këto organe. Ai i paraqet Asamblesë së Përgjithshme një raport të përvitshëm në lidhje me veprimtarinë e organizatës.

Neni 99

Sekretari i Përgjithshëm mund të tërheqë vëmëndjen e Këshillit të Sigurisë në lidhje me çdo çështje, që sipas gjykimit të tij mund të rrezikojë paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare.

Neni 100

(1) Sekretari i Përgjithshëm, së bashku me punonjësit e tjerë, nuk duhet as të kërkojnë dhe as të pranojnë udhëzime nga ndonjë qeveri apo autoritet jashtë organizatës gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre. Ata nuk duhet të ndër marrin asnjë veprim, që do të mund të dëmtonte pozicionin e tyre si punonjës ndërkombëtar, që mbajnë përgjegjësi vetëm ndaj organizatës së tyre.

(2) Secili prej anëtarëve të Kombeve të Bashkuara është i detyruar të respektojë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësisë së Sekretarit të Përgjithshëm dhe të punonjësve të tjerë dhe të mos tentojë t'i ndikojë ata gjatë realizimit të detyrave të tyre.

Neni 101

(1) Punonjësit caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

(2) Në dispozicion të Këshillit Ekonomik dhe Social, të Këshillit të Kujdestarisë dhe, në rast se duhet, edhe organeve të tjera të Kombeve të Bashkuara vihen punonjës të përhershëm të përshtatshëm. Ata janë pjesë e Sekretariatit.

(3) Gjatë marrjes në punë të punonjësve dhe rregullimit të marrëdhënies së tyre të punës, me rëndësi vendimtare është pikëpamja, a sipas së cilës duhet të garantohet maksimumi i efektivitetit, i kompetencës dhe i ndershmërisë. Faktori i rëndësishëm së një shpërndarjeje sa më të gjerë gjeografike gjatë përzgjedhjes së punonjësve duhet marrë në konsideratë në masën e duhur.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XVI: Të ndryshme

Neni 102

(1) Të gjitha kontratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga një anëtar i Kombeve të Bashkuara pas hyrjes në fuqi të kësaj Karte, duhen rregjistruar sa më shpejt të jetë e mundur pranë Sekretariatit dhe të publikohen prej tij.

(2) Nëse këto kontrata apo marrëveshje ndërkombëtare nuk rregjistrohen sipas paragrafit 1, atëherë palët e tyre kontraktore në një organ të Kombeve të Bashkuara nuk mund t'u referohen atyre.

Neni 103

Nëse detyrimet e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, që rezultojnë nga kjo Kartë bien ndesh me ato që ata marrin përsipër në kuadër të marrëveshjeve të

tjera ndërkombëtare, atëherë detyrimet që rrjedhin nga Karta kanë përparësi.

Neni 104

Organizata gëzon në territorin shtetëror të secilit prej anëtarëve ato të drejta juridike dhe administrative, që janë të nevojshme për realizimin e detyrave dhe për arritjen e qëllimeve të saj.

Neni 105

(1) Organizata gëzon në territorin shtetëror të secilit prej anëtarëve të gjitha privilegjet dhe imunitetet, që janë të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

(2) Përfaqësuesit e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara dhe punonjësit e organizatave gëzojnë gjithashtu të gjitha privilegjet dhe imunitetet, për të cilat ata kanë nevojë, që të mund të realizojnë në pavarësi të plotë të gjitha detyrat e tyre në kuadër të organizatës.

(3) Asambleja e Përgjithshme mund të japë rekomandime për të rregulluar zbatimin e paragrafeve 1 dhe 2, ose për këtë qëllim mund t'u propozojë marrëveshje anëtarëve të Kombeve të Bashkuara.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XVII: Dispozita të përkohshme në lidhje me sigurinë

Neni 106

Derisa hyrja në fuqi e marrëveshjeve të posaçme të karakterit të përcaktuar në nenin 43 t'i japë mundësi Këshillit të Sigurimit të fillojë të ushtrojë përgjegjësitë e tij sipas nenit 42, palët e deklaratës së katër fuqive, nënshkruar në Moskë në datën 30 tetor 1943, dhe Franca konsultohen me njëra-tjetrën sipas paragrafit 5 të kësaj deklaratë dhe, në rast se duhet edhe me anëtarë të tjerë të Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të vendosin bashkarisht, në emër të organizatës, të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e paqes botërore dhe sigurisë ndërkombëtare.

Neni 107

Ato masa, që qeveritë përgjegjëse i marrin apo miratojnë si pasojë e Luftës së Dytë Botërore kundër një shteti, që gjatë luftës ishte armik i një shteti nënshkruarës së kësaj Karte, as nuk shfuqizohen dhe as nuk ndalohen nga kjo Kartë.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XVIII: Ndryshime

Neni 108

Ndryshimet e kësaj Karte hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara, nëse ato pranohen me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe nëse ratifikohen nga dy të tretat e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara përfshirë këtu të gjithë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit sipas së drejtës së tyre kushtetuese.

Neni 109

(1) Për rishikimin e kësaj Karte mund të thirret një Konferencë e Përgjithshme e të gjithë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara; momenti dhe vendi përcaktohen me vendim të dy të tretave të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe me vendim të nëntë anëtarëve çfarëdo të Këshillit të Sigurimit. Çdo anëtar i kombeve të Bashkuara ka të drejtën e një vote në konferencë.

(2) Çdo ndryshim i kësaj Kartë, i cili rekomandohet nga Konferenca me një shumicë prej dy të tretash, hyn në fuqi, sapo të ratifikohet nga dy të tretat e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara përfshirë këtu të gjithë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurisë sipas së drejtës së tyre kushtetuese.

(3) Nëse një konferencë e tillë nuk është mbledhur ende para sesionit të dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme pas hyrjes në fuqi të kësaj Karte, atëherë në rendin e ditës së këtij sesioni do të parashikohet edhe propozimi për thirrjen e një konference të tillë; konferenca zhvillohet, nëse kjo përcaktohet me vendim të shumicës së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe me vendim të shtatë anëtarëve çfarëdo të Këshillit të Sigurimit.

[\[Përmbledhje kapitujsh\]](#) [\[Kreu i faqes\]](#)

Kapitulli XIX: Ratifikimi dhe nënshkrimi**Neni 110**

(1) Kjo Kartë duhet ratifikuar nga shtetet nënshkruese sipas së drejtës së tyre kushtetuese.

(2) dokumentat e ratifikimit depozitohen pranë qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës; kjo e fundit i notifikon çdo depozitim të gjitha shteteve nënshkruese dhe Sekretarit të Përgjithshëm, nëse ai është i emëruar.

(3) Kjo Kartë hyn në fuqi, sapo Republika e Kinës, Franca, Bashkimi Sovjetik, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe shumica e shteteve nënshkruese të kenë depozituar dokumentat e tyre të ratifikimit. Menjëherë pas kësaj qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ngre një zyrë protokolli për depozitimin e dokumentave të ratifikimit nëpërmjet së cilës ajo u dërgon kopje të gjitha shteteve nënshkruese.

(4) Shtetet nënshkruese të kësaj Karte, që e kanë ratifikuar atë, pas hyrjes së saj në fuqi, ditën e depozitimit të dokumentit të ratifikimit të tyre bëhen anëtarë fillestarë të Kombeve të Bashkuara.

Neni 111

Kjo Kartë, tekstet e së cilës në gjuhën kineze, franceze, ruse, angleze dhe spanjolle janë njësoj të detyrueshme, depozitohet në arkivin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo e fundit u përcjell më pas shteteve të tjera nënshkruese kopje të noterizuara.

NË DËSHMI TË KËSAJ përfaqësuesit e qeverive të Kombeve të Bashkuara nënshkruan këtë Kartë.

Bërë në San Francisko, datë 26. Qershor 1945.

[Nënshkrimet]

[Përmbledhje kapitujsh] [Kreu i faqes]

Temat: [Të drejtat e njeriut](#) | [Modele](#) | [Demokracia](#) | [Partitë](#) | [Evropa](#) | [Globalizimi](#) | [Kombet e Bashkuara](#) | [Qëndrueshmëria](#)

Metodat: [Didaktika politike](#) | [Pedagogjia e edukimit](#) | [Metodat](#)

[d@dalos](#)

[home](#)

[site map](#)

Kjo ofertë Online mbi edukimin politik u zhvillua nga [agora-wissen](#), Shoqata e Shtutgartit për përçim dijesh përmes mediave te reja dhe edukimit politik. Në rast pyetjesh apo vërejtjesh drejtohuni Ju lutem te ne.